



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.566/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Hatixhe Qestaj me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.566/2021 i paraqitur nga Hatixhe Qestaj me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Hatixhe Qestaj me vendbanim në Zvicër, me të cilën pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e ka eliminuar nga lista për regjistrimin e votuesve jashtë Kosove, për të njejtat arsye të Ukë Qestaj. Kërkon nga PZAP-i që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosove.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ me të cilën është njoftuar se iu është refuzuar aplikacioni, formularin e aplikimit, kopjen e emailit me të cilën ka aplikuar, si dhe dokumentin e identifikues (letërnjoftimin).

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 10:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur me këtë apel të parashtruar nga Hatixhe Qestaj, është aplikuar nga email adresa elektronike isuf_qestaj@outlook.com me të cilën kanë pranuar gjithsejtë 14 aplikacione për regjistrim (për 14 persona), mirëpo edhe pse me mbiemër të njejtë, këto aplikacione i përkasin aplikuesve që për vendbanim kanë tri shtete të ndryshme, si Zvicër (përfshirë ankuesin në fjalë), të tjerët Gjermani dhe Suedi. Në vazhdim të përgjigjës theksohet se të gjithë personat me mbiemrin Qestaj (mbiemër i njejtë) nuk cilësohen si rreth i ngushtë familjarë, për shkak se duke përfshirë edhe ankuesit edhe personat tjerë që kanë vendbanim në Gjermani dhe Suesi, aplikacionet të të cilëve janë dërguar nga po e njëjta e-mail adresë "isuf_qestaj@outlook.com" nuk janë cilësuar si rreth i ngushtë familjarë, për arsye se për vendbanim kanë shtete të ndryshme dhe për këtë arsye janë refuzuar që të gjithë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesja e apelit Hatixhe Qestaj gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka bërë aplikim për regjistrim përmes Isuf Qestaj dhe e njehta nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se Isuf Qestaj ka pasur autorizim për të aplikuar në emër të apeluesit. Paneli gjithashtu ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë për persona me mbiemër të njëjtë dhe që nuk kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë rreth familjar i ngushtë pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në lidhje të ngushtë familjare, andaj edhe emri i saj nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkojnë në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së- ku përcaktohet **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie e tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Hatixhe Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 566/2021 më datën 01.09.2021

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

